

Albania Marketing Service Shpk
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve neto në kapital	3
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	5 – 30

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarit dhe Këshillit Drejtues të Albania Marketing Service Shpk,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albania Marketing Service Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Shoqërisë në përputhje me Nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart, kur, të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operationet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNRF-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencat të njafueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010, Tirana, Albania,
Tiranë, Shqipëri
Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS):
L41709002H



Partner Angazhimi
Auditues Ligjor
Enida Cara

7 Maj 2021
Tiranë, Shqipëri

Albania Marketing Service Shpk

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktive			
Aktive afatgjata materiale	5	309,539,282	323,765,103
Aktive afatgjata jo-materiale	6	1,558,534	1,028,679
Aktive me të drejtë përdorimi	7	855,773,249	443,720,889
Investime në filiale	8	-	7,066,080
Totali i aktiveve afatgjata		1,166,871,065	775,580,751
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	9	1,329,153,767	277,217,127
Llogari të tjera të arkëtueshme	9	1,301,775,444	741,305,738
Aktive të tjera	10	271,492,417	298,021,881
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	502,519,815	573,841,082
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,404,941,443	1,890,385,828
Totali i aktiveve		4,571,812,508	2,665,966,579
Detyrimet dhe kapitali			
Kapitali i paguar	13	12,300,000	12,300,000
Rezervat	14	242,289,469	242,289,469
Fitimet e mbartura		2,260,048,157	1,156,270,628
Totali i kapitalit		2,514,637,626	1,410,860,097
Detyrime ndaj palëve të lidhura	15	109,299,171	58,829,548
Llogari të pagueshme	16	43,234,921	74,480,988
Tatim fitimi i pagueshëm		126,454,932	23,714,304
Detyrime të tjera	17	901,647,578	654,523,477
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	18	271,156,770	241,304,970
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,451,793,372	1,052,853,287
Detyrimet afatgjata të qirasë	18	605,381,510	202,253,195
Totali i Detyrimeve afatgjata		605,381,510	202,253,195
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		4,571,812,508	2,665,966,579

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 30 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albania Marketing Service Shpk

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shërbimet	19	6,561,002,919	4,489,407,389
Të ardhura të tjera	20	63,521,318	30,119,832
Shpenzime personeli:			
Shpenzime personeli të shërbimit	21	(3,061,223,189)	(2,257,981,582)
Shpenzime personeli administrativ	21	(519,279,997)	(341,707,962)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,6	(224,826,919)	(140,901,026)
Zhvlerësim dhe amortizim i qirasë	7	(298,092,543)	(282,083,925)
Zhvlerësim i investimeve në filiale	8	(7,066,080)	(10,599,120)
Zhvlerësimi llogarive të arketureshme	9	(1,817,091)	-
Shpenzime të tjera operative	22	(688,652,842)	(497,110,740)
Fitimi nga aktivitetet operative		1,823,565,576	989,142,866
Të ardhura financiare		-	-
Shpenzime financiare		(31,411,907)	(30,558,612)
Shpenzime interesi mbi detyrimet e qirasë		(22,429,743)	(13,899,984)
Shpenzime financiare, neto	23	(53,841,650)	(44,458,596)
Fitimi para tatimit		1,769,723,926	944,684,270
Tatimi mbi fitimin	24	(343,037,200)	(168,790,468)
Fitimi neto i periudhës		1,426,686,726	775,893,802
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën		1,426,686,726	775,893,802

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 30 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albania Marketing Service Shpk

Pasqyra e ndryshimeve neto në kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020


(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Kapital i paguar	Fitime të mbartura	Rezerva	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	12,300,000	760,646,773	242,289,469	1,015,236,242
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin				
Fitimi neto i vitit	-	775,893,802	-	775,893,802
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	775,893,802	-	775,893,802
Veprime me aksionerët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	-
Dividend të shpërndarë	-	(380,269,947)	-	(380,269,947)
Totali i veprimeve me aksionerët	-	(380,269,947)	-	(380,269,947)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	12,300,000	1,156,270,628	242,289,469	1,410,860,097
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin				
Fitimi neto i vitit	-	1,426,686,726	-	1,426,686,726
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	1,426,686,726	-	1,426,686,726
Veprime me aksionerët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	-
Dividend të shpërndarë	-	(322,909,198)	-	(322,909,199)
Totali i veprimeve me aksionerët	-	(322,909,198)	-	(322,909,199)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	12,300,000	2,260,048,157	242,289,469	2,514,637,626

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 30 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë Albania Marketing Service Shpk më datë 6 maj 2021 dhe u nënshkruan në emër të saj nga:


Diego Pisa
Drejtor ekzekutiv


STUDIO "PUSHINA" Sh.p.k
NIPT-i: LU1320002B
Rr. "Abdyr Frashëri" 31, Pallati
Studio Pustina
Përgatitësi

Albania Marketing Service Shpk

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi përpara tatimit		1,769,723,926	944,684,270
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,7	522,582,480	421,854,797
Amortizimi	6	336,981	1,130,153
Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve	9	1,817,091	-
Zhvlerësimi i investimeve në filiale	8	7,066,080	10,599,120
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata		(5,128,328)	(416,453)
Shpenzime nga interesat	23	22,429,743	13,899,984
<i>Ndryshime në detyrimet dhe asetet operationale:</i>			
(Rënie) në të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të arkëtueshme		(1,614,223,437)	(263,624,986)
(Rënie) në aktive të tjera		(10,940,886)	(92,375,302)
Rritje/(Rënie) në detyrime ndaj palëve të lidhura		50,469,622	(13,877,685)
(Rënie) në të pagueshme ndaj furnitorëve		(31,246,067)	(9,592,081)
Rritje në detyrimet e tjera		247,124,101	246,866,877
<i>Flukset e mjeteve monetare të gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>		<u>960,011,306</u>	<u>1,259,148,694</u>
Tatimi mbi fitimin i paguar	24	(202,826,220)	(128,736,391)
Flukset neto të mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		<u>757,185,086</u>	<u>1,130,412,303</u>
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	5,6	(211,467,187)	(131,989,278)
Arkëtime nga shitjet e aktiveve afatgjata		5,464,563	1,062,361
Flukset neto të mjeteve monetare përdorur në veprimtaritë investuese		<u>(206,002,624)</u>	<u>(130,926,917)</u>
Flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë financuese			
Ripagim i detyrimeve të qirasë		(299,594,531)	(296,146,633)
Dividend të paguar		(322,909,199)	(380,269,947)
Flukset neto të mjeteve monetare përdorur në veprimtaritë financuese		<u>(622,503,730)</u>	<u>(676,416,580)</u>
(Ulja)/Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(71,321,268)	323,068,806
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 Janar 2020		573,841,083	250,772,276
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor 2020	12	<u>502,519,815</u>	<u>573,841,082</u>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 30 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Albania Marketing Service Shpk (“Shoqëria”) u themelua si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 20 shkurt 2009 dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 25 shkurt 2009. Shoqëria zotërohej plotësisht nga Albania Investment Holdings Mauritius deri më 14 Shkurt 2018. Me pas aksionet e saj janë shitur tek Teleperformance SE. Shoqëria mëmë përfundimtare është Teleperformance SE e cila është gjithashtu selia qendrore e grupit.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është sigurimi i shërbimeve të telemarketingut klientëve të grupit Teleperformance.

Shoqëria vepron nëpërmjet qendrave të telefonisë në Tiranë dhe në Durrës. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 3,741 punonjës (2019: 2,789 punonjës).

Shoqëria zotëron një filial në Shqipëri, Service 800 Albania Shpk, që operon në tregun e shërbimeve telemarketing. **Service 800 Albania Shpk (100% pronësi)** - është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 14 korrik 2009, dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 20 korrik 2009.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të veçanta janë paraqitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ky është seti i parë i pasqyrave financiare të Shoqërisë në të cilat aplikohet SNRF 16 *Qiratë*. Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël janë paraqitur në shënimin 3.

Shoqëria mëmë përfundimtare, Teleperformance France SE, ka përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të për Shoqërinë dhe për filialin e saj Shërbimi 800 Albania Shpk. Pasqyrat financiare të konsoliduara gjenden në <https://www.teleperformanceinvestorrelates.com/>. Në mënyrë që të përftohet informacioni i plotë mbi pozicionin financiar, që rezulton nga veprimtaritë dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit në tërësi, përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare të veçanta duhet t'i lexojnë ato së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të veçanta janë paraqitur në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vijimësisë, e cila supozon se vullneti i Shoqërisë është të jetë në gjendje të njohë pasuritë e saj dhe të shlyejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit.

Në 11 Mars ,2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaroi një situatë pandemie si rrjedhojë e emergjencës globale të shkaktuar nga ndërprerja e COVID-19. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet e qeverisë shqiptare kanë implementuar një sërë masash për të limituar përhapjen dhe impaktin e COVID-19, si ndalimi dhe kufizimi i udhëtimit, karantina për personat e infektuar, ashtu sikurse edhe vendosja e kufizimeve në aktivitetin e biznesit, deri në mbylljen e tyre. Masat e mësipërme u lehtësuan gradualisht gjatë 2020 dhe 2021. Këto masa, mes të tjerave, kanë limituar aktivitetin ekonomik në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht në të. Ky impact mund të vazhdojë të ketë një impact negative në biznese, pjesëmarrësit në tregje, bankat, si në Shqipëri dhe globalisht për një periudhë kohë të panjohur.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(d) Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Në fazat e para të izolimit, Shoqëria ka ndërmarrë hapa konkrete kundër epidemisë në kohën e duhur për të siguruar shëndetin e punonjësve të saj dhe të mbajë prodhimin dhe operacionet në rrjedhë normale në mënyrën e duhur, dhe ka ndërmarrë gjithashtu një sërë masash për të siguruar dhënien në kohë të shërbimit tek klientët. Si rrjedhojë, në 2020 nuk ka pasur një impact të qënësishëm në 2020 në aftësinë e saj të vijimësisë dhe nuk ka pasur probleme likuiditeti. Po ashtu, nuk ka nevojë të bëhen rregullime të pasqyrave financiare për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2020.

Epidemia e COVID-19 nuk ka impact në bizensin lokal të shoqërisë dhe manxhimi beson se nuk do të ketë ndonjë impact në aftësinë e saj të vijimësisë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kryesore të kontabilitetit janë paraqitur më poshtë. Politikat e kontabilitetit të përcaktuara më poshtë kanë qenë aplikuar vazhdimisht gjatë të gjitha periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Njohja e të ardhurave

Në maj 2014, BSNK publikoi SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët", për të zëvendësuar SNK 18 "Të ardhurat", i cili përcakton parimet për raportimin e informacionit të dobishëm të përdoruesit e pasqyrave financiare në lidhje me natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë e të ardhurave dhe flukseve të parave që vijnë nga kontratat me klientët të njësie ekonomike. Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar, 2018, me zbatimin e kërkuar retrospektiv dhe lejimin e miratimit të hershëm. Miratimi i SNRF 15 nuk ka një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, pa zbritje dhe shitje të lidhura me taksat. Të ardhurat nga shërbimet maten në bazë të kontratës, kryesisht si një rritje e drejtpërdrejtë e kostove direkte dhe indirekte në lidhje me shërbimet e ofruara, ose si një shumë fikse e kontraktuar. Të ardhurat njihen kur (i) shërbimet e identifikuara sipas kontratës së shitjes, pranohen thelbësisht nga klienti për secilën fushë, (ii) Shoqëria përmbush detyrimin e saj të performancës pas përfundimit të shërbimeve, dhe (iii) shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në fitim ose humbje në proporcion me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë.

Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj njihen në fitim ose humbje.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Përfitimet e punonjësve

(i) Skemë me kontribute të përcaktuara

Shoqëria paguan kontribute fikse për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve të saj mbi daljen në pension. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet, në bazë të një plani kontributesh të përcaktuara.

(ii) Lejet vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuar në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

(d) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga veprimet në monedhë të huaj. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet nga veprimet në monedhë të huaj.

(e) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet duke përdorur normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur këto të rikthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Aktivi për tatimet e shtyra njihet në masën që është e mundshme që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë të disponueshme kundrejt së cilës mund të shfrytëzohet ndryshimi i përkohshëm. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në secilën datë të raportimit dhe zvogëlohen deri në atë masë sa nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor i lidhur do të ketë të realizohet. Shoqëria ka vendosur të mos njohë aktivet e tatimeve të shtyra në ato pasqyrat financiare.

Aktivitet dhe detyrimet e tatimeve të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjrisht për të kompensuar aktivet dhe detyrimet e tatimit aktual, dhe ato kanë të bëjnë me tatimet mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor për të njëjtën njësi të tatueshme ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata synojnë të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore aktuale në a baza neto ose aktivet dhe detyrimet e tyre tatimore do të njihen njëkohësisht.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksat dhe interesat shtesë mund të jenë të detyrueshme. Shoqëria beson që përlllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë adekuate për të gjitha vitet e hapura tatimore bazuar në vlerësimin e saj mbi shumë faktorë, përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh në lidhje me ngjarjet në të ardhmen. Informacioni i ri mund që bëhet i disponueshëm dhe bën që Shoqëria të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në pasivet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet e taksave në periudhën që bëhet përcaktimi.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Në 31 Dhjetor 2020 dhe 2019, ka diferenc të përkohshme midis vlerës kontabël të asetëve për qëllime raportimi financiar dhe vleravë për qëllime takse. Si rrjedhim rezulton, një taksë e shtyrë asset në vlerën 43,124,598 Lekë. Manaxhimi i Shoqërisë ka vlerësuar të mos e njohë këtë shumë duke konsideruar pasigurinë në lidhje me rikuperueshmërinë e kësaj shume si rrjedhojë e interpretimit të ndryshëm në taksë.

(f) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiratë operative njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë për qiranë njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së saj.

(g) Aktivitet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme në blerjen e aktivitetit. Kostot e huamarrjes të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e aktiveve të kualifikueshme njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ndodhin. Programet kompjuterike të blera që janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjeve të lidhura me to kapitalizohen si pjesë e këtyre pajisjeve. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i vlerës së arkëtuar nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivitetit dhe njihen neto tek të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostot e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihen në vlerën kontabël të aktivitetit afatgjatë material vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivitetin dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e përbërësit të zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitime ose humbje në momentin që ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi shumën e amortizueshme, që është kostoja e një aktivi, ose shuma tjetër e zëvendësuar për koston, minus vlerën e tij të mbetur.

Amortizimi i aktiveve materiale llogaritet duke përdorur metodën lineare, me norma të cilat përafrojnë me jetën mesatare ekonomike të dobishme të aktiveve. Jetët e dobishme respektive për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si në vijim:

Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	2-5 vite
Automjete	5 vite
Mobilje dhe orendi	4-5 vite
Pajisje telefonike	5 vite
Pajisje kompjuterike	2-4 vite

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale, nëse janë të konsiderueshme, rivlerësohen në çdo datë raportimi.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëpasshme për aktivet jomateriale kapitalizohen vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në momentin që ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare. Periudha e amortizimit është 2-4 vjet.

(i) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, që të qeverisë politikën financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Në përputhje me paragrafin 4(a) të SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Shoqëria plotëson kriteret për përjashtimin nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Mëma përfundimtare e Shoqërisë, Teleperformance SE, inkorporuar në Paris, France përgatit pasqyra financiare të konsoliduara që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF') dhe janë në dispozicion për përdorim publik. Aksionerët nuk kundërshtojnë që Shoqëria të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare të veçanta kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje të investimit në filiale janë të vendosura në Shënimin 8.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera kontabël e mbetur e tyre mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse vlera e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme. Vlera kontabël e mbetur e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

(j) Kapitali i paguar

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale. Kostot rritëse direkt të ngarkuara në emetimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si deduksion, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara është regjistruar si premium i aksioneve në kapital. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Për çdo dividend të deklaruar pas datës së bilancit dhe para se pasqyrat financiare individuale të autorizohen për publikim janë dhënë informacion shpjegues në shënimin e ngjarjeve pas datës së bilancit.

(k) Instrumentet financiare

(i) Aktivet financiare jo-derivative

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGj - investim në instrumente borxhi; VDATGj - investim në instrumente të kapitalit; ose VDPFH. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përjashtuar rastin kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për drejtimin e aktiveve financiare, rast kur riklasifikohen të gjitha aktivet e ndikuara.

Në njohjen fillestare të një investimi në kapital që nuk mbahet për shitje, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të investimit në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGj). Një vendim i tillë merret individualisht për çdo investim.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(k) Instrumentet financiare (vazhdim)

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli pasi kjo reflekton më së miri mënyrën se si drejtohet biznesi dhe informacionin që i ofrohet drejtimit. Informacioni përfshin:

Aktivitetet financiare - Vlerësimi i modelit të biznesit:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimi i këtyre politikave në praktikë. Këtu përfshihet nëse strategjia e drejtimit përqendrohet në fitimin e flukseve monetare kontraktuale, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e ndonjë detyrimi të lidhur ose daljen e flukseve monetare ose duke realizuar flukset e mjeteve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet drejtimit të Shoqërisë
- rreziqet që ndikojnë performancën e modelit të biznesit (dhe aktivitetet financiare të mbajtura në këtë model biznesi) dhe si menaxhohen rreziqet.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në bankë.

(i) *Aktivitetet financiare jo-derivative*

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë regjistruar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo rënie të vlerës.

(ii) *Detyrime financiare jo-derivative*

Të pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

(m) Zhvlerësimi

(i) *Aktivitetet financiare*

Shoqëria njih zbritje për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar. Zbritja e humbjeve për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare maten gjithmonë me vlerën e barabartë me humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së aktivitetit. Gjatë vlerësimit nëse rreziku kreditor i një aktiviteti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe gjatë vlerësimit të humbjes së pritshme të kredisë, Shoqëria konsideron informacione të arsyeshme të cilat janë të disponueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta. Kjo përfshin informacionin cilësor dhe sasior, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë, vlerësimin e kredisë dhe informacionin për të ardhmen.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(m) Zhvlerësimi (vazhdim)

Matja e HPK-ve

HPK-të janë vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (d.m.th diferenca mes flukseve monetare kontraktuale dhe mjeteve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë).

Drejtimi ka përdorur lehtësinë praktike të zbatimit të matricave të provizioneve për të matur humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës të llogarive të arkëtueshme që vlerësohen në baza kolektive.

Për llogaritë e arkëtueshme që vlerësohen individualisht, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme duke përdorur metoda te ndryshme, në varësi mënyrës se si pritet të rikuperohen shumat e arkëtueshme, si p.sh.:

- shuma e rikuperueshme sipas një skenari hipotetik likuiditeti;
- shuma e skontuar e shitjes sipas metodës fluks monetar/shërbimi i borxhit;
- normat e rregulluara të provizionit (duke iu referuar normave të provizionit të përdorura për vlerësim kolektiv duke bërë përshtatje bazuar në skenarë specifikë si p.sh. kontratat me elementë të rëndësishëm të financimit).

Paraqitja e zbritjes për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Zbritjet për HPK-të nga aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar i zbriten vlerës kontabël bruto të aktiveve. Për letrat me vlerë të borxhit me VDATGj, humbja e kredisë kalon në fitimin ose humbjen e periudhës dhe njihet në ATGj.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të tij. Shoqëria nuk pret rikuperim të konsiderueshëm nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare të çregjistruara mund të mbeten objekt i aktiviteteve përbarimore për të qenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave për t'u arkëtuar.

(n) Provigjonet

Provigjonet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të shkuar, dhe është e mundur që të kërkohet një dalje burimesh që përmbajnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe që detyrimi të mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse efekti është material, provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të parasë me një normë para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut, të vlerës në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme edhe rrezikun specifik të detyrimit. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më i mundshëm kushti për të cilin do të kërkohet materializimi i burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin, atëherë provigjonet kthehen pas. Provigjonet përdoren vetëm për arsye për të cilën janë njohur fillimisht. Provigjonet nuk njihen për humbje operative të ardhshme.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(o) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumatat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

A. Gjykimet

Informacion në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave të kontabilitetit që kanë efektet më të rëndësishme mbi shumatat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet më poshtë:

i) Provizionet dhe ekspozimet fiskale

Për të përcaktuar nëse një provizion duhet të regjistrohet, Shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka ndonjë rrezik të identifikuar dhe të matshëm në flukset monetare të ardhshme, për shembull ato që lidhen me tatimet dhe gjogat. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim në kushtet ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me humbje të mundshme. Drejtimi përdor vlerësimet bazuar në humbje të shkuara dhe prova objektive të zhvillimeve aktuale të ngjashme kur bën vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si sasinë edhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës me humbjet.

ii) Vlerat e drejta

Aktivitetet financiare

Meqë mjetet monetare në arkë, llogaritë në banka, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tregut për to konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e mbartur. Politikat për zhvlerësimin dhe çregjistrimin janë përshkruar në shënimin 3(m).

Detyrimet financiare jo-derivative

Detyrimet financiare janë afatshkurtra dhe vlera e drejtë e tyre është njohur e barabartë me vlerën e mbartur.

iii) Matja e HPK-ve për llogaritë e arketueshme

Politika e zhvlerësimit është përshkruar në shënimin 3(m).

B. Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacion në lidhje me fushat e pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave të kontabilitetit që kanë efektin më të rëndësishëm në shumatat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në Shënimin 4 (o) Ndryshimet në politikat e rëndësishme të kontabilitetit dhe Shënimin 7 Aktive me të Drejtë Përdorimi.

(p) Ndryshimet në politikat e kontabilitetit

Shoqëria ka zbatuar për herë të parë SNRF 16 “Qiratë” nga 1 janari 2019. Një numër standardesh të reja janë bërë efektive duke filluar nga 1 janari 2019, por nuk kanë pasur ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Shoqëria ka zbatuar SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, sipas së cilës zbatimi fillestar nuk ka efekt kumulativ në fitimet e pashpërndara më 1 janar 2019. Rrjedhimisht, informacioni krahasues i paraqitur për vitin 2018 nuk është rivlerësuar, pra ai paraqitet, siç është raportuar më parë, sipas SNK 17 dhe interpretimeve përkatëse. Detajet e ndryshimeve në politikat kontabël janë shpalosur më poshtë. Për më tepër, kërkesat në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese sipas SNRF 16 në përgjithësi nuk janë zbatuar për informacionin krahasues.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(p) Ndryshimet në politikat e kontabilitetit (vazhdim)

Në lidhjen e një kontrate, Shoqëria përcakton nëse kontrata është ose përmban një kontratë qiraje. Një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje, nëse jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohore të përcaktuar në këmbim të pagesës së një shume. Për të vlerësuar nëse një kontratë e caktuar i jep të drejtën për të përdorur një aktiv të identifikuar, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë sipas SNRF 16. Kjo politikë është zbatuar mbi kontratat e lidhura në dhe pas datës 1 janar 2019.

Si qiramarrës

Në momentin e lidhjes apo modifikimit të një kontrate që përmban një qira, Shoqëria përcakton shumën në kontratë të ndarë për secilin përbërës së qirasë mbi bazën e çmimit relativ përkatës të tij. Sidoqoftë, për qiratë e ndërtesave, Shoqëria ka vendosur që të kombinojë përbërësit jo-qira me përbërësit qira dhe t'i trajtojë ato si një përbërës i vetëm i qirasë.

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim për qiranë në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet fillimisht me koston e tij, që përmban shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar me çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, plus çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin për çmontimin dhe lëvizjen e aktivit bazë, restaurimin e aktivitet apo vendit në të cilin është vendosur aktivi, minus çdo stimul qiraje të marrë.

Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet nëpërmjet metodës lineare nga dita e fillimit të qirasë deri në fund të afatit të qirasë, përveç nëse qiradhënësi transferon pronësinë e aktivitet bazë tek Shoqëria në përfundim të afatit të qirasë ose nëse kostoja e aktivitet me të drejtë përdorimi reflekton se Shoqëria do të ushtrojë një opsion blerjeje. Në këtë rast, aktivi me të drejtë përdorimi do të amortizohet përgjatë jetës së dobishme të aktivitet bazë, që përcaktohet mbi të njëjtat baza si për aktivet afatgjata materiale. Gjithashtu, vlera e aktivitet me të drejtë përdorimi ulet periodikisht me humbjen nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet me vlerën e ndonjë ri-matjeje të caktuara për detyrimin e qirasë.

Detyrimi për qiranë njihet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar ende në atë datë, të skontuara me normën e interesit të përcaktuar të qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, do të përdoret norma rritëse e huamarrjes e Shoqërisë. Përgjithësisht, Shoqëria përdor normën rritëse të huamarrjes për të skontuar pagesat e qirasë.

Shoqëria përcakton normën rritëse të huamarrjes duke marrë norma interesi nga burime të ndryshme të jashtme financimi dhe duke bërë rregullime të ndryshme për të reflektuar termat e qirasë dhe llojin e aktivitet të marrë me qira.

Pagesat e qirasë që përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga elementët më poshtë:

- pagesat fikse, duke përfshirë këtu dhe pagesat fikse në-thelb,
- pagesat variabël të qirasë, të cilat varen nga një indeks ose normë, që maten fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit,
- shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, pagesat e qirasë për një periudhë rinovimi opsionale nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin e zgjatjes së afatit të qirasë dhe pagesat e gjobave për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme që nuk do të përfundojë kontratën para kohe.

Detyrimi për qiranë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Detyrimi rivlerësohet kur ka ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë, të cilat vijnë nga ndryshimi në një indeks ose normë, kur ka ndryshim në vlerësimet e Shoqërisë mbi shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë, nëse Shoqëria ndryshon përcaktimin e saj për të ushtruar një opsion blerjeje. zgjatje të afatit apo një opsion të përfundimit të qirasë ose nëse ka ndonjë rishikim në pagesat fikse në-thelb të qirasë.

Kur detyrimi për qiranë rimatet në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël neto të aktivitet me të drejtë përdorimi ose regjistrohët ndryshimi në fitim ose humbje e vitit nëse vlera e aktivitet me të drejtë përdorimi zvogëlohet në zero.

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët

Shoqëria ka vendosur të mos njohë aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime për qira për qiratë me vlerë të ulët të aktivitet dhe qiratë afatshkurtra, duke përfshirë pajisjet informatike.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(p) Ndryshimet në politikat e kontabilitetit (vazhdim)

Si qiramarrës (vazhdim)

Shoqëria njeh pagesat e qirasë për këto qira si shpenzim mbi bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Në periudhën krahasuese, si qiramarrëse, Shoqëria i klasifikonte qiratë, të cilat transferonin në mënyrë të konsiderueshme rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, si qira financiare.

Në të tilla raste, aktivet e marra me qira mateshin fillimisht me vlerën më të ulët midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pagesat minimale të qirasë ishin pagesat që qiramarrësi detyrohej të kryente përgjatë afatit të qiramarrjes, duke përfshirë qiratë eventuale. Pas njohjes fillestare, aktivet llogariteshin në përputhje me politikën kontabël të aplikueshme për atë aktiv.

Aktivitetet e mbajtura si qira të tjera, klasifikoheshin si qira operative dhe nuk njiheshin në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë. Pagesat e kryera për qiratë operative njiheshin në fitim ose humbjen e vitit mbi një bazë lineare mbi afatin e qirasë. Stimujt e marrë për qiratë njiheshin si pjesë integrale e shpenzimeve totale për qiratë përgjatë afatit të qirasë.

A. Përcaktimi i qirasë

Më parë, Shoqëria përcaktonte në fillim të kontratës nëse një marrëveshje ishte ose përbante një qira sipas KIRFN 4 "Përcaktimi nëse një Marrëveshje përban një Qira". Shoqëria tani vlerëson nëse një marrëveshje përban një qira bazuar në përkufizimin e qirasë, siç shpjegohet në Shënimin 6 (m).

Shoqëria zbatoi SNRF 16 vetëm mbi kontratat që ishin identifikuar më parë si qira. Kontratat, të cilat nuk përbanin një qira sipas SNK 17 dhe KIRFN 17, nuk u rivlerësuan nëse identifikonin një të tillë sipas SNRF 16. Prandaj, përkufizimi i qirasë sipas SNRF 16 u zbatua vetëm mbi kontratat e lidhura apo të ndryshuara në ose pas datës 1 janar 2019.

B. Si qiramarrës

Si qiramarrës, Shoqëria merr me qira ambjente zyre, magazina dhe automjete. Shoqëria më parë i ka klasifikuar qiratë si qira të zakonshme ose financiare bazuar në vlerësimin e saj nëse qiraja i transferonte në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe shpërblimet të lidhura me pronësinë e aktivitetit në Shoqëri. Sipas SNRF 16, Shoqëria njeh aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për shumicën e këtyre qirave, duke i përfshirë kështu në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në momentin e lidhjes apo modifikimit të një kontrate që përban një qira, Shoqëria përcakton në kontratë vlerësimin e saj për secilin përbërës së qirasë mbi bazën e madhësisë relative të çmimit të tij specifik.

Sidoqoftë, për qiratë e ndërtesave, Shoqëria ka vendosur që të kombinoj përbërësit jo-qira me përbërësit qira dhe t'i trajtojë ato si një përbërës i vetëm i qirasë.

(q) ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE TË RISHIKUARA TË RAPORTIMIT FINANCIAR

(i) Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën raportuese aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është më ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin më ose pas fillimit të asaj periudhe).

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shpalosjet"** - Reforma e Referencës së Normës së Interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

(q) ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE TË RISHIKUARA TË RAPORTIMIT FINANCIAR (vazhdim)

(i) Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën raportuese aktuale (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)

- Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(ii) Standardet dhe interpretimet që nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** përfshirë përmirësimet e SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),

- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** – Referencë e Kuadrin Konceptual me përmirësimet e SNRF 3, (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),

- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** – Zgjatje e Përrjashtimeve të përkohshme nga aplikimi i SNRF 9 (data e mbarimit për përjashtimet e përkohshme nga SNRF 9 u zgjat në periudha vjetore duke nisur në ose pas 1 janar 2023,

- **Ndryshimet në SNRF 10 "Konsolidimi i pasqyrave financiare" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose ndërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për një kohë të pacaktuar deri në përfundimin e projektit kërkimor mbi metodën e kapitalit),

- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** - Konçesionet e Qirasë në lidhje me Covid-19 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet zbatimi i mëparshëm, përfshirë pasqyrat financiare që nuk janë autorizuar ende për tu lëshuar në 28 maj 2020. Ndryshimi është gjithashtu i disponueshëm për raportet e ndërmjetme),

- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** -Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),

- **Ndryshimet në SNK 16 "Prona, makineri dhe pajisje"** - Të ardhura para përdorimit të synuar (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022),

- **Ndryshimet në SNK 37 "Provigjione, detyrime të kushtëzuara dhe aktive të kushtëzuara"** - Kontrata në vazhdimësi - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022)

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shënime Shpjeguese" SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe SNRF 16 "Qira"** - Reforma e Normës së Interesit bazë (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021),

- **Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF (cikli 2018 -2020)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9 dhe SNK 41 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2022. Ndryshimi në SNRF 16 ka të bëjë vetëm me një shembull ilustrues, kështu që nuk deklarohet asnjë datë efektive).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

4. INSTRUMENTET FINANCIARE – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

4.1 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to është përafërsisht e njëjtë me vlerën e mbartur të paraqitur, për shkak të maturimit të tyre të shkurtër. Vlera e drejtë e kërkesave të arkëtueshme dhe të pagueshme është e përafërt me vlerën e mbartur për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër.

4.2 Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e Shoqërisë ndaj secilit nga risqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut. Shënime të tjera sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë për krijimin dhe mbikëqyrjen e kornizës së menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet më të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve e procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Zyrat Qendrore të Grupit mbikëqyrin se si Drejtimi monitoron pajtueshmërinë me Grupin dhe Shoqërinë mbi politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe rishikon përshtatshmërinë e kornizës së menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet me të cilat përballet Shoqëria. Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga vlerat monetare në arkë dhe në bankë, të pagueshmet nga palët e lidhura dhe të arkëtueshmet dhe detyrimet e tjera tregtare.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

4. INSTRUMENTET FINANCIARE – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

4.2 Përcaktimi i vlerës së drejtë(vazhdim)

(a) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për shkak të vëllimit të kufizuar dhe diversitetit të klientëve bazë të Shoqërisë, e cila është kryesisht me palët e lidhura, përqendrimet e rrezikut kreditor në lidhje me llogaritë e arkëtueshme tregtare janë të kufizuara. Për balancat e të arkëtueshmeve me palët e lidhura, ju lutemi shihni shënimin 9.

Vlera kontabël e aktiveve financiare paraqet ekspozimin maksimal kreditor:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	1,329,153,767	277,217,127
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,301,775,444	741,305,738
Totali	2,630,929,211	1,018,522,865

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor për kërkesat për arkëtim në datën e raportimit sipas pozicionit gjeografik është:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Vendas	17,532,440	15,940,193
Jo vendas	2,613,396,771	1,002,582,672
Totali	2,630,929,211	1,018,522,865

Humbjet nga zhvlerësimi

Provizioni për kërkesat e dyshimta për arkëtim është caktuar në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar rrezikun potencial në mbledhjen e balancave të llogarive të arkëtueshme.

Analiza sipas vjetërsisë e kërkesave për arkëtim në datën e raportimit është:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Më pak se një vit	2,629,921,345	1,023,216,373
Më shumë se një vit	62,711,250	55,192,785
Gjendje në fund të vitit	2,692,632,595	1,078,409,158
Zhvlerësim i të arkëtueshmeve	(61,703,384)	(59,886,293)
Gjendje neto në fund të vitit	2,630,929,211	1,018,522,865

Tabelat më poshtë prezantojnë pasqyrat financiare për 2020 dhe 2019 sipas stadeve të IFRS 9:

Stadet sipas Humbjes së Pritur në Asetet Financiare 31 Dhjetor 2020

	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	TOTAL
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të arkëtueshme	2,629,921,345	-	62,711,250	2,692,632,595
Vlera bruto	2,629,921,345	-	62,711,250	2,692,632,595
Humbjet e pritshme të kredisë	-	-	(61,703,384)	(61,703,384)
Vlera kontabël, net	2,629,921,345	-	1,007,866	2,630,929,211

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

4. INSTRUMENTET FINANCIARE – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

4.2 Përcaktimi i vlerës së drejtë(vazhdim)

(b) Rreziku kreditor(vazhdim)

Stadet sipas Humbjes së Pritur në Asetet Financiare 31 Dhjetor 2019

	Stadi 1	Stadi 2	Stadi 3	TOTAL
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të arkëtueshme	1,018,522,865	4,693,508	55,192,785	1,078,409,158
Vlera bruto	1,018,522,865	4,693,508	55,192,785	1,078,409,158
Humbjet e pritshme të kredisë	0	(4,693,508)	(55,192,785)	(59,886,293)
Vlera kontabël, net	1,018,522,865	-	-	1,018,522,865

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do ndeshet në vështirësi në përmbushjen e angazhimeve të lidhura me detyrimet financiare të cilat shlyhen duke dhënë para të gatshme ose ndonjë aktiv tjetër financiar. Drejtimi është në gjendje të përfitojë me shpejtësi pagesa nga palët e lidhura për kërkesat e arkëtueshme në kushtet e rënies së likuiditetit.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit kontraktual duke përfshirë pagesën e interesave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Vlera kontabël	6 ose më pak muaj
<i>31 dhjetor 2020</i>		
<i>Aktivët financiarë</i>		
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	1,329,153,767	1,329,153,767
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,301,775,444	1,301,775,444
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	502,519,815	502,519,815
	3,133,449,026	3,133,449,026
<i>Detyrimet financiare</i>		
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(109,299,171)	(109,299,171)
Llogari të pagueshme	(43,234,921)	(43,234,921)
	(152,534,092)	(152,534,092)
Ekspozimi Neto	2,980,914,934	2,980,914,934
<i>31 dhjetor 2019</i>		
<i>Aktivët financiarë</i>		
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	277,217,127	277,217,127
Llogari të tjera të arkëtueshme	741,305,738	741,305,738
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	573,841,082	573,841,082
	1,592,363,947	1,592,363,947
<i>Detyrimet financiare</i>		
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(58,829,548)	(58,829,548)
Llogari të pagueshme	(74,480,988)	(74,480,988)
	(133,310,536)	(133,310,536)
Ekspozimi Neto	1,459,053,411	1,459,053,411

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

4. INSTRUMENTET FINANCIARE –Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

4.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i monedhës

Shoqëria ka balanca të konsiderueshme në Euro me klientët e saj, me palët e lidhura dhe kundrejt furnitorëve të saj, që e ekspozojnë Shoqërinë ndaj rrezikut të monedhës. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik. Kurset e këmbimit të përdorura përgjatë vitit ishin si më poshtë:

Lek	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Kursi mesatar	Kursi në datën e raportimit	Kursi mesatar	Kursi në datën e raportimit
EUR	123.8	123.7	123.00	121.77
USD	108.7	100.8	109.84	108.64

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

31 dhjetor 2020	Vlera kontabël	EUR	Lek	USD
	(vlera të paraqitura në Lek)			
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të arkëtueshme	2,630,929,211	2,613,371,465	17,532,440	25,307
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	502,519,815	469,161,473	33,358,342	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(109,299,171)	(109,299,171)	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	(43,234,921)	(21,931,005)	(21,303,916)	-
Ekspozimi Neto	2,980,914,934	2,951,302,761	29,586,867	25,307

31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	EUR	Lek	USD
	(vlera të paraqitura në Lek)			
Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të arkëtueshme	1,018,522,865	1,002,256,685	15,969,273	296,907
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	573,841,082	568,564,185	5,276,897	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(58,829,548)	(58,829,548)	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	(74,480,988)	(33,807,000)	(38,172,213)	(2,501,775)
Ekspozimi Neto	1,459,053,411	1,478,184,322	(16,926,043)	(2,204,868)

Analiza e ndjeshmërisë

Duke menaxhuar rrezikun e normave të interesit dhe të këmbimit valutor, Shoqëria synon të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Një forcim ose dobësim i Lek-ut sikurse tregohet më poshtë, kundrejt Euro do të zvogëlonte ose rriste respektivisht, kapitalin dhe fitimin me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë bazohet në një ndryshim prej 10% në kursin e këmbimit që Shoqëria e gjykon si të mundshëm në fund të periudhës së raportimit.

Lek	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
EUR	295,130,276	(295,130,276)	147,818,432	(147,818,432)
USD	(2,531)	2,531	(220,487)	220,487

Rreziku i normës së interesit

Më 31 dhjetor 2020 huaja dhënë palëve të lidhura fiton interes me normë fikse dhe ndryshimet në normat e interesit të tregut nuk do të kishin ndikim në pozicionin financiar të Shoqërisë.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

INSTRUMENTET FINANCIARE –Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

4.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Administrimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është ruajtja e një baze të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Grupi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit pjesëtuar për totalin e kapitalit. Drejtimi dhe Grupi gjithashtu monitorojnë nivelin e dividendëve.

Shoqëria synon ruajtjen e një balance midis kthimeve më të larta të cilat bëhen të mundura nga nivele më të larta borxhi dhe avantazheve dhe sigurisë që të jep një kapitalizim i fuqishëm.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave rregullatore të kapitalit.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshte:

	Kompjuter dhe pajisje	Mobilje dhe orendi	Pajisje telefonike	Përmirësime të ambjenteve me qira	Automjete	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2019	466,545,232	261,800,712	67,997,055	148,641,589	12,437,428	957,422,016
Shtesa	70,552,489	23,447,927	8,390,661	29,176,164	-	131,567,241
Pakësime	-	(5,001,070)	-	-	-	(5,001,070)
Më 31 dhjetor 2019	537,097,721	280,247,569	76,387,716	177,817,753	12,437,428	1,083,988,187
Shtesa	170,980,375	25,260,765	397,708	8,886,490	5,975,344	211,500,682
Pakësime	(33,153,678)	(1,824,471)	(606,763)	(244,137)	-	(35,829,049)
Më 31 dhjetor 2020	674,924,418	303,683,863	76,178,661	186,460,106	18,412,772	1,259,659,820
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 janar 2019	(335,742,832)	(148,570,669)	(47,350,084)	(82,086,061)	(11,057,729)	(624,807,375)
Shpenzimi i vitit	(64,879,429)	(40,138,096)	(9,218,665)	(24,309,177)	(1,225,506)	(139,770,873)
Pakësime	-	4,355,163	-	-	-	4,355,163
Më 31 dhjetor 2019	(400,622,261)	(184,353,602)	(56,568,749)	(106,395,238)	(12,283,235)	(760,223,085)
Shpenzimi i vitit	(72,642,049)	(66,871,210)	(8,319,812)	(75,905,139)	(751,728)	(224,489,938)
Pakësime	34,197,441	140,745	162,022	72,765	-	34,572,973
Më 31 dhjetor 2020	(439,047,357)	(251,084,067)	(64,726,539)	(182,227,612)	(13,034,963)	(950,096,232)
Vlera kontabël neto						
Më 1 janar 2019	130,802,400	113,230,043	20,646,971	66,555,528	1,379,699	332,614,641
Më 31 dhjetor 2019	136,475,460	95,893,967	19,818,967	71,422,515	154,193	323,765,102
Më 31 dhjetor 2020	235,877,061	52,599,795	11,452,122	4,232,494	5,377,809	309,539,281

Nuk ka asnjë aktiv afatgjatë material të vendosur si garanci për ndonjë linjë kredie më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

6. Aktivet afatgjata jo-materiale

	Licensa për programe
Kosto	
Më 1 janar 2019	21,378,901
Shtesa	422,037
Pakësime	(56,712)
Më 31 dhjetor 2019	21,744,226
Shtesa	866,836
Pakësime	-
Më 31 dhjetor 2020	22,611,062
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2019	(19,642,106)
Shpenzimi i vitit	(1,130,153)
Pakësime	56,712
Më 31 dhjetor 2019	(20,715,547)
Shpenzimi i vitit	(336,981)
Pakësime	-
Më 31 dhjetor 2020	(21,052,528)
Vlera kontabël	
Më 1 janar 2019	1,736,795
Më 31 dhjetor 2019	1,028,679
Më 31 dhjetor 2020	1,558,534

7. Aktivet me të drejtë përdorimi

Aktivitet me të drejtë përdorimi maten me kosto (që përfshin kostot fillestare direkte, çdo pagesë qiraje të përpara ose me fillimin e qirasë minus stimujt) minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë. Aktivitet me të drejtë përdorimi amortizohen në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Aktivitet me të drejtë përdorimi	1,435,949,717	725,804,814
Amortizimi i akumuluar i Aktivitet me të drejtë përdorimi	(580,176,468)	(282,083,925)
Totali	855,773,249	443,720,889

Marrëveshjet e qirasë së Shoqërisë përmbushin kriteret për t'u identifikuar si qira për të cilën qiramarrësi njih një aktiv me të drejtë përdorimi. Këto kontrata kanë të bëjnë me qira te ndryshme nga qiratë afatshkurtra dhe me vlerë të ulët, për këtë arsye Shoqëria ka njohur një aktiv për qiramarrësin dhe detyrimin përkatës të qirasë.

8. Investimi në filial

Investimi në filial për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	2020	2019
Vlera kontabël në 1 janar	7,066,080	17,665,200
Rritje në kuotat e kapitalit të filialit	-	-
Vlera bruto në 31 dhjetor	7,066,080	17,665,200
Zhvlerësimi për investimin në filial	(7,066,080)	(10,599,120)
Vlera kontabël në 31 dhjetor	-	7,066,080

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

8. Investimi në filial (vazhdim)

Investimi ne filial perfshin investimin e mbajtur me kosto tek Service 800 Albania Shpk. Shoqëria bleu ne 2018 100% të kuotave të Service 800 Albania Shpk për shumën 17,665,200 lek. Në 2019, Drejtimi vendosi që te zhvlerësojë pjesërisht zërin e investimit në filial për shkak të pezullimit të përkohshëm të aktivitetit të Service 800 Albania Shpk dhe në vitin 2020 menaxhimi vendosi të zhvlerësojë të gjithë balancën e mbetur të investimit sepse shoqëria vijon të jetë në status të pezulluar për një afat të pacaktuar.

9. Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
In & Out S.p.a a Socio Unico	1,071,610,126	198,513,360
TELEPERFORMANCE EMEA	192,293,337	36,680,552
Teleperformance Support Services GmbH	40,048,721	-
TLS Contact Albania	7,152,119	7,152,119
LANGUAGE LINE, LLC	6,326,537	3,522,592
PERFECTCALL Teleperformance Holland	4,887,787	4,811,526
Tëenty4 Help Kosovo	2,164,750	-
Teleperformance USA	1,788,400	-
Teleperformance Group Inc	1,494,793	-
Praxidia S.p.A. a socio Unico	1,360,700	-
Teleperformance Group/USD	25,307	1,027,722
Service 800 Albania	1,190	4,288,084
TP Support Services GmbH	-	21,143,491
Teleperformance USA	-	77,680
Total Pale te Lidhura	<u>1,329,153,767</u>	<u>277,217,127</u>

Llogaritë e arkëtueshme në 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme	1,363,478,828	801,192,031
Zhvlerësim për borxhin e keq	(61,703,384)	(59,886,293)
Total receivables, net of alloëance	<u>1,301,775,444</u>	<u>741,305,738</u>

Lëvizjet për zhvlerësimin paraqiten si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Gjendja në fillim të vitit	(59,886,293)	(60,958,470)
Shpenzim zhvlerësimi për vitin	(1,817,091)	-
Zhvlerësim i anuluar gjatë vitit	-	1,072,177
Gjendja në fund të vitit	<u>(61,703,384)</u>	<u>(59,886,293)</u>

Menaxhimi ka vendosur të njohë një zhvlerësim në llogaritë e arkëtueshme në vlerën 1,817,091 lekë.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

10. Aktive të tjera

Aktivitetet e tjera për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Tatimi mbi vlerën e shtuar	269,094,560	242,197,191
Provizion për zhvleresim në TVSH	(80,672,660)	(18,575,260)
Garanci për qira	17,375,993	16,806,997
Të tjera	65,694,524	57,592,953
Totali	271,492,417	298,021,881

Manaxhimi vlerëson rregullisht rikuperueshmërinë e aseteve si rrjedhojë e pasigurisë së interpretimeve në tatime. Për këtë qëllim, ato kanë njohur një provigjion për zhvlerësimin e TVSH së arkëtueshme (Referojuni notës 3e).

Kategoria "Të tjera" përbëhet kryesisht nga qiraja e parapaguar e ndërtesës në Millenium për shumën prej 45,926,549 Lek dhe pjesa e mbetur nga parapagime për licenca ose shërbime.

11. Hua dhënë palëve të lidhura

Të gjitha huatë e dhena palëve të lidhura janë paguar plotësisht në 2019, dhe në 2020 nuk ka pasur hua të dhëna palëve të lidhura.

12. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Vlera në llogari bankare	501,530,063	573,319,617
Vlera në arkë	989,752	521,465
Totali	502,519,815	573,841,082

13. Kapitali i paguar

Më 31 dhjetor 2020 kapitali i autorizuar, emtuar dhe i paguar i Shoqërisë është 12,300,000 Lek. Një përmbledhje e kapitalit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jepet më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Mbajtësi i kuotave	Lek	Mbajtësi i kuotave	Lek
Teleperformance SE	100%	12,300,000	100%	12,300,000

Në 2018, Shoqëria mëmë transferoi 100% të aksioneve nga Albania Invest Holding Mauritius tek Teleperformance SE. Shoqëria nuk kishte të drejta, preferenca apo kufizime të lidhura me kapitalin më 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Gjatë vitit 2020, u shpernda dividend në shumën Lek 322,909,199 nga fitimi i mbartur prej 2,256,922,918 leke (2019: 1,156,270,628).

14. Rezervat

Sipas ligjit të mëparshëm të shoqërive tregtare në Shqipëri, shoqëritë tregtare ishin të detyruara të transferonin një minimum prej pesë perqind të ardhurave neto siç paraqitet në librat kontabël në rezerva ligjore deri sa kjo rezervë bëhej e barabartë me një të dhjetën e kapitalit të paguar dhe kjo shumë nuk mund të shpërndahet. Më 14 prill 2008, një ligj i ri për shoqëritë hyri në fuqi në Shqipëri, i cili nuk kërkon që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të krijojë rezerva ligjore. Përdorimi i rezervës ligjore mbetet në vullnetin e ortakut të Shoqërisë.

Rezervat për vitin 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rezerva ligjore	20,518,249	20,518,249
Rezerva të tjera	221,771,220	221,771,220
Totali	242,289,469	242,289,469

Rezervat e tjera janë njohur me vendim të ortakut me qëllim për tu mbajtur dhe përdorur në të ardhmen.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

15. Detyrime ndaj palëve të lidhura

Detyrimet ndaj palëve të lidhura për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Teleperformance SA	44,740,795	21,666,329
Tp Emea	25,692,397	33,246,531
Teleperformance Support Services GmbH	18,695,465	-
Teleperformance Europe Middle East and Africa	16,491,743	-
Teleperformance Poland	2,942,332	-
Teleperformance Italia	562,297	-
Teleperformance Hellas Sa	89,742	-
Teleperformance Deutschland	54,398	2,118,680
TELEPERFORMANCE ESPAÑA S.A.U.	23,107	-
TELEPERFORMANCE PORTUGAL S.A.	6,895	-
IN & OUT Spa	-	1,798,008
Totali	<u>109,299,171</u>	<u>58,829,548</u>

16. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve	43,234,921	74,480,988
Totali	<u>43,234,921</u>	<u>74,480,988</u>

17. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të përlllogaritura përfitime punonjës	343,898,993	118,031,677
Detyrime ndaj personelit	306,704,612	200,756,655
Tatimi mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore	108,081,821	55,790,104
Shpenzime të përlllogaritura	81,430,459	18,495,626
Shpenzime të përlllogaritura për tatim në burim	9,821,291	10,295,023
Tatimi i mbajtur në burim	1,306,412	10,422,876
Detyrime të tjera	50,403,990	240,731,516
Totali	<u>901,647,578</u>	<u>654,523,477</u>

Shpenzimet e përlllogaritura për tatimin në burim përfshijnë tatimin në burim të evidentuar vecantë për faturat nga furnitorët e huaj që janë në procedurë për aplikimin e taksimit të dyfishtë.

18. Detyrimet e qirasë

Detyrimet e qirasë detajohen si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	271,156,770	241,304,970
Detyrimet afatgjata të qirasë	605,381,510	202,253,195
Totali	<u>876,538,280</u>	<u>443,558,165</u>

Pas datës së fillimit, afati i qirasë rivlerësohet me ndodhjen e një ngjarjeje të rëndësishme ose të një ndryshimi të rëndësishëm në rrethana që është brenda kontrollit të qiramarrësit dhe ka ndikim nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme që do të ushtrojë një opsion të pa përfshirë më parë në përcaktimin e afatit të qirasë, ose nuk do të ushtrojë një opsion që është përfshirë më parë në përcaktimin e qirasë.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

18. Detyrimet e qirasë (vazhdim)

Politika e afatit të qirasë e përcakton afatin e qirasë për çdo qira si një periudhë të pa anulueshme ose periudha gjatë së cilës Albania Marketing Service shpk nuk ka mundësi të zgjidhë kontratën pa një penalitet monetar dhe periudhën gjatë së cilës Albania Marketing Service shpk është arsyeshme e sigurt që nuk do të ushtrojë mundësinë e shkëputjes së kontratës. Kjo periudhë është përgjithësisht 5 vjet.

Albania Marketing Service shpk ka përdorur një model të siguar nga Grupi për të përcaktuar IBR, i cili përdor kurbat e normave të kthimit EURIBOR për Europën dhe LIBOR për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një premium prej 1.5% është marrë në konsideratë që të pasqyrojë një marzh të kredisë në rritje të normës së huamarrjes për një rrezik shtesë lidhur me filialet, siç është Albania Marketing Services. IBR e ponderuar i përdorur për llogaritjen e detyrimit të qirasë është 2.64% për ndërtesat.

Sipas SNRF 16, pagesat e ndryshueshme të qirasë që janë të lidhura me performancën e ardhshme ose përdorimin e një aktivi themelor përjashtohen nga përkufizimi i pagesave të qirasë. Si pasojë, nuk është njohur asnjë detyrim për ato pagesa të ndryshueshme të qirasë të paraqitura më poshtë.

Pagesat minimale të qirasë për qiratë fikse janë si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Brenda 1 viti	271,156,770	241,304,970
Midis 1 dhe 2 viteve	187,368,535	181,140,880
Midis 2 dhe 3 viteve	175,737,774	21,112,315
Më shumë se 3 vite	242,275,201	-
TOTAL	876,538,280	443,558,165

Pagesat e tjera që nuk përfshihen në detyrimet e qirasë të paraqitura në shpenzimet operative:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Pagesa të ndryshueshme të qirasë	-	-
Aktive me vlerë të ulët të qirasë	10,470,011	8,854,917
Totali	10,470,011	8,854,917

Për më tepër, shpenzimi interesit financiar i njohur përgjatë vitit 2020 është 22,429,743 Lekë. (2019: 13,899,984).

19. Të ardhura nga shërbimet

Të ardhura nga shërbimet për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Palë të treta të tjera	4,431,263,339	2,584,950,703
Palë të lidhura (shiko shënimin 25)	2,129,739,580	1,904,456,686
Totali	6,561,002,919	4,489,407,389

20. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga shërbime të tjera	50,818,740	28,041,295
Të ardhura nga qiraja	12,702,578	2,078,538
Totali	63,521,318	30,119,833

Të ardhura nga shërbime të tjera përfshijnë shërbime që janë kryer nga punonjësit e AMS për kompanitë e grupit.

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

21. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga - supervizorë	2,640,829,808	1,955,005,255
Paga - agjentë	241,991,217	293,155,859
Përfitime të tjera	178,402,163	9,820,468
Shpenzimet e personelit të shërbimit	3,061,223,188	2,257,981,582
Personeli administrativ	519,279,997	341,707,962
Shpenzime të personelit administrativ	519,279,997	341,707,962
Totali	3,580,503,185	2,599,689,544

Shpenzimet e personelit të shërbimit përfaqësojnë koston e agjentëve dhe mbikëqyrësve të përfshirë në fushata. Shpenzimet për personelin janë të detajuara si më poshtë:

	2020	2019
Paga dhe bonuse	3,129,613,344	2,256,191,638
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	450,889,842	343,497,906
Totali	3,580,503,186	2,599,689,544

22. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet e tjera operative për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tarifa për të drejta shfrytëzimi	187,436,901	120,006,395
Shërbime mirëmbajtje dhe teknologjie	152,113,819	106,639,872
Shpenzime konsulence dhe ligjore	94,770,218	40,197,414
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	77,222,970	76,004,416
Taksa të tjera	64,728,248	20,097,192
Komunikim, siguri dhe teknologji informacioni	40,905,523	42,585,963
Mirëmbajtje dhe riparime	20,175,021	17,337,735
Shërbime të tjera konsulence	14,044,833	11,152,736
Shpenzime të tjera operative	13,347,634	17,354,126
Udhëtime dhe aktivitete	10,018,371	33,564,056
Shpenzime qiraje	8,653,761	8,854,917
Tarifa çertifikimi dhe anëtarësimi	4,301,297	1,573,839
Shpenzime marketingu	934,246	1,742,077
Totali	688,652,842	497,110,738

Taksa të tjera janë rritur si rrjedhojë e provigjionit që shoqëria ka njohur në lidhje me rikuperueshmërinë e TVSH së arkëtueshme.

23. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura financiare		
Të ardhura nga interesat	-	-
	-	-
Shpenzime financiare		
Humbje neto nga këmbimi	(31,411,907)	(30,558,612)
Shpenzime interesi nga detyrimet e qirasë	(22,429,743)	(13,899,984)
	(53,841,650)	(44,458,596)
Shpenzime financiare neto	(53,841,650)	(44,458,596)

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

24. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	343,037,200	168,790,468
	343,037,200	168,790,468

Pozicionet e taksës të paqarta të shoqërisë jaë rivlerësuar nga manaxhimi në fund të cdo periudhe raportuese. Shoqëria ka njohur detyrim tatim fitimit të përcaktuar nga manaxhimi i cili nuk pritët që të rritët nga ndryshime të mundshme që mund të ndodhin nga autoritetet e taksave. Vlerësimi bazohët në interpretimin e ligjeve të taksave që kanë hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit, dhe cdo vendim gjykate ose rregulla të tjera të lidhura me këto çështje. Detyrimet për gjobat, interest dhe taksat janë njohur në vlersimin më të mire të manaxhimit si shpenzime të kryera për shlyerjen e detyrimeve në fund të poeriudhës raportuese.

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 15% (2019: 15%) të fitimit të tatueshëm. Në vijim paraqitet një rakordim midis tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin:

	2020 %	2020 Në Lek	2019 %	2019 Në Lek
Fitimi para tatimit		1,769,723,926		944,684,270
Efekti i tatimit mbi fitimin me normë standarde	15%	265,458,589	15%	141,702,641
Efekti i shpenzimeve të panjohura	4%	77,578,611	3%	28,340,528
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19%	343,037,200	18%	170,043,169

Shpenzimet jo të zbritshme për vitin e përfunduar 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Kategoria e shpenzimeve jo të zbritshme</i>		
Detyrime për shpërblimet e punonjësve	225,901,563	5,515,018
Zhvlerësimi	98,379,138	82,285,071
Provigjone për taksa	62,097,400	-
Të tjera	130,812,639	75,266,704
Totali I shpenzime jo të zbritshme	517,190,741	163,066,793

Lëvizjet në tatimin mbi fitimin paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tatim fitim i pagueshëm më 1 janar	23,714,302	(16,339,773)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	343,037,200	168,790,468
Rimbursim Tatim Fitimi	(37,470,350)	-
Parapagime gjatë vitit	(202,826,220)	(128,736,391)
Tatim fitimi i pagueshëm më 31 dhjetor	126,454,932	23,714,304

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

25. Palët e lidhura

Shoqëria ka palë të lidhura shoqërinë Albania Investment Holdings Mauritius, shoqëria mëmë direkte dhe shoqërinë mëmë përfundimtare Teleperformance France SA, dhe shoqëritë që janë nën kontrollin e shoqërisë mëmë përfundimtare të grupit të paraqitura në tabelën më poshtë.

Shoqëria ka palë të lidhura gjithashtu edhe drejtuesit dhe drejtorët ekzekutivë në formën e kompensimit të pagave dhe bonuseve.

Gjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksionet e mëposhtme me palët e lidhura:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Pagesa për:		
<i>Tarifa për të drejta shfrytëzimi:</i>		
Teleperformance SE	165,762,381	120,006,395
<i>Kosto e blerje të tjera:</i>		
TP Emea	110,526,346	78,554,690
Teleperformance Deutschland - Service GmbH	16,954,170	24,145,484
Teleperformance Group Inc	13,269,359	8,963,829
Teleperformance Europe Middle East and Africa	12,261,011	-
In & Out S.p.a, Italy	6,718,442	730,878
Teleperformance USA	2,153,516	16,258
Teleperformance SE	1,004,514	646,247
Teleperformance Hellas	599,080	-
Teleperformance Espana	154,085	-
Teleperformance Portugal	52,992	-
Totali	329,455,896	233,063,781
Të ardhura (shënimi 16):		
In & Out S.p.a, Italy	1,413,235,886	1,419,262,669
TP Emea	657,962,459	442,773,094
Language line, Llc	54,266,480	42,420,924
Praxidia S.p.A. a socio unico	4,274,755	-
Totali	2,129,739,580	1,904,456,687
<i>Të ardhura të tjera</i>		
TP Support Services GmbH	37,166,366	-
TP EMEA	5,896,809	26,617,408
Teleperformance Support Services GmbH	2,861,626	-
Tënty4Help Kosovo	2,496,579	-
Service 800 Albania Sh.p.k	-	405,545
Totali	48,421,380	27,022,953

Për gjendjet në fund të vitit 2020 dhe 2019 referojuni shënimeve 9, 15 dhe 16. Kompensimi i drejtuesve kryesorë të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 114,990,103 Lek (2019: 115,387,219 Lek).

Albania Marketing Service Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

26. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Çështjet ligjore

Shoqëria nuk është subjekt i çështjeve ligjore, pretendimeve dhe mosmarrëveshjeve të lindura në kushte të zakonshme biznesi.

Angazhime për qiratë operationale

Shoqëria ka marrë angazhime për qiranë për ambientet e saj, të cilat janë të anulueshme me njoftim paraprak nga një në gjashtë muaj. Më 31 dhjetor 2020, maksimumi i angazhimeve të paanullueshme të pagueshme është zero.

27. Ngjarje pas datës së raportimit

Manaxhimi i shoqërisë nuk ka dijeni për ndonjë ngjarje tjetër përveç sa më sipër, pas datës së raportimit për të cilat nevojiten rregullime apo shënime shpjeguese në pasqyrat financiare.